



**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

*Qeveria-Vlada-Government*

*Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrašnjih Poslova / Ministry of Internal Affairs*

**Akademia e Kosovës për Siguri Publike  
/ Kosovska Akademija za Javnu Bezbednost / Kosovo Academy  
for Public Safety**

**Këshilli i Etikës / Ethics Council / Etički Savet**

---

# **MANUAL PËR ETIKË DHE INTEGRITET AKADEMIK**

# PËRMBAJTJA

---

|                                                                                                                                                                                                                                                                  |    |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| I. HYRJE .....                                                                                                                                                                                                                                                   | 5  |
| <ul style="list-style-type: none"><li>• Qëllimi i Manualit</li><li>• Rëndësia e Integritetit Akademik</li><li>• Fusha e Zbatimit</li></ul>                                                                                                                       |    |
| II. KORNIZA INSTITUCIONALE .....                                                                                                                                                                                                                                 | 7  |
| <ul style="list-style-type: none"><li>• Roli i Institucionit</li><li>• Roli i Këshillit të Etikës</li><li>• Roli i Stafit Akademik</li><li>• Roli i Studentëve</li></ul>                                                                                         |    |
| III. INTEGRITETI AKADEMIK .....                                                                                                                                                                                                                                  | 8  |
| <ul style="list-style-type: none"><li>• Koncepti</li><li>• Shkeljet</li></ul>                                                                                                                                                                                    |    |
| IV. ETIKA E HULUMTIMIT .....                                                                                                                                                                                                                                     | 9  |
| <ul style="list-style-type: none"><li>• Parimet</li><li>• Transparenca dhe të dhënat</li><li>• Liria akademike</li><li>• Trajtimi i pjesëmarrësve</li><li>• Autorësia dhe publikimet</li><li>• Konflikti i interesit</li><li>• Sjelljet e papranueshme</li></ul> |    |
| V. EDUKIMI DHE PROMOVIMI I INTEGRITETIT .....                                                                                                                                                                                                                    | 11 |
| <ul style="list-style-type: none"><li>• Trajnimet dhe zhvillimi profesional</li><li>• Informimi dhe ndërgjegjësimi</li><li>• Roli i Këshillit të Etikës në promovim</li></ul>                                                                                    |    |
| VI. PROCEDURAT INSTITUCIONALE .....                                                                                                                                                                                                                              | 12 |
| <ul style="list-style-type: none"><li>• Raportimi</li><li>• Fillimi i procedurës</li><li>• Shqyrtimi</li><li>• Të drejtat e palëve</li><li>• Vendimmarrja</li></ul>                                                                                              |    |
| VII. MONITORIMI DHE PËRDITËSIMI .....                                                                                                                                                                                                                            | 14 |

## LISTA E SHKURTESAVE

|                               |                                                                                                                                                                                                                                                                                |
|-------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>AKSP</b>                   | Akademia e Kosovës për Siguri Publike                                                                                                                                                                                                                                          |
| <b>AKA</b>                    | Agjencia e Kosovës për Akreditim                                                                                                                                                                                                                                               |
| <b>AKK</b>                    | Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve                                                                                                                                                                                                                                            |
| <b>FSP</b>                    | Fakulteti i Sigurisë Publike                                                                                                                                                                                                                                                   |
| <b>ICITAP</b>                 | Trajnimi Ndërkombëtar i Hetimeve Kriminale Përkrahja Programore                                                                                                                                                                                                                |
| <b>OSBE</b>                   | Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë                                                                                                                                                                                                                                |
| <b>BE</b>                     | Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë                                                                                                                                                                                                                                            |
| <b>IHZH</b>                   | Instituti për Hulumtim dhe Zhvillim                                                                                                                                                                                                                                            |
| <b>ISP</b>                    | Institucionet e Sigurisë Publike që veprojnë në AKSP                                                                                                                                                                                                                           |
| <b>PK</b>                     | Policia e Kosovës                                                                                                                                                                                                                                                              |
| <b>IPK</b>                    | Inspektorati Policor i Kosovës                                                                                                                                                                                                                                                 |
| <b>AME</b>                    | Agjencioni i Menaxhimit Emergjentë                                                                                                                                                                                                                                             |
| <b>SHKK</b>                   | Shërbimi Korrektues i Kosovës                                                                                                                                                                                                                                                  |
| <b>SHSK</b>                   | Shërbimi Sprovues i Kosovës                                                                                                                                                                                                                                                    |
| <b>DK</b>                     | Dogana e Kosovës                                                                                                                                                                                                                                                               |
| <b>MPB</b>                    | Ministria e Punëve të Brendshme                                                                                                                                                                                                                                                |
| <b>Palët e interesit</b>      | Institucionet e Sigurisë Publike, duke mos u kufizuar vetëm në: Policia e Kosovës (PK), Dogana e Kosovës (DK), Shërbimi Korrektues i Kosovës (SHKK), Shërbimi Sprovues i Kosovës (SHSK), Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) dhe Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave (AME) |
| <b>Vijues</b>                 | Personat të cilët vijnë trajnime dhe arsim të lartë në Akademi                                                                                                                                                                                                                 |
| <b>Partnerët Ndërkombëtar</b> | Partnerët e përhershëm që veprojnë dhe bashkëpunojnë me AKSP-në si ICITAP, OSBE,                                                                                                                                                                                               |
| <b>Bordi i AKSP-së</b>        | Organ i cili vepron në kuadër të AKSP-së i cili vendos për standardet minimale profesionale, politikat e trajnimit dhe edukimin e specializuar dhe të avancuar për ASP-të.                                                                                                     |
| <b>Këshilli FSP-së</b>        | Organi më i lartë akademik i FSP-së i cili vendos për të gjitha çështjet e rëndësishme në fushën e mësim, kërkimit dhe hulumtimit shkencor                                                                                                                                     |

## BAZA INSTITUCIONALE - LIGJORE

Rregulloret që lidhen me etikën dhe integritetin

❖ **Rregullorja për Kodin e Etikës në AKSP**

→ rregullon standardet e sjelljes profesionale dhe morale

❖ **Rregullorja për procedurat dhe masat etike për personelin akademik të AKSP-së**

→ trajton shkeljet etike dhe përgjegjësinë disiplinore të stafit

❖ **Rregullorja për shkeljet, masat dhe procedurën disiplinore për vijuesit/studentët në AKSP**

→ integriteti akademik i studentëve

❖ **Rregullore (AKSP) nr. 03/2025 për etikë dhe integritet në hulumtimin shkencor**

→ plagjiatura, konflikt interesi, ndershmëri kërkimore

❖ **Politika institucionale për etikën dhe integritetin akademik**

→ parandalimi i mashtrimit dhe plagjiaturës, edukimi etik

❖ **Rregullorja për përgjegjësinë disiplinore të personelit akademik**

→ bazë për trajtimin e shkeljeve të etikës

| Fusha                         | Akti normativ                                    | Çfarë rregullon       | Lidhja me etikën dhe integritetin |
|-------------------------------|--------------------------------------------------|-----------------------|-----------------------------------|
| <b>Sjellja profesionale</b>   | Kodi i Etikës                                    | Standardet e sjelljes | Bazë e etikës institucionale      |
| <b>Disiplina e stafit</b>     | Rregullorja për procedurat dhe masat etike       | Shkeljet e stafit     | Mekanizëm ndëshkues               |
| <b>Disiplina e studentëve</b> | Rregullorja disiplinore për vijuesit             | Sjellja e studentëve  | Integritet akademik               |
| <b>Hulumtimi shkencor</b>     | Rregullorja për etikë dhe integritet në hulumtim | Integriteti kërkimor  | Plagjiatura, konflikt interesi    |
| <b>Politika akademike</b>     | Politika për etikë dhe integritet akademik       | Parandalim & edukim   | Kulturë institucionale            |
| <b>Procedurat</b>             | Ligji i procedurës administrative                | Drejtësi procedurale  | Trajtim i drejtë i rasteve        |
| <b>Marrëdhëniet e punës</b>   | Ligji i punës / zyrtarët publik                  | Përgjegjësi ligjore   | Bazë juridike disiplinore         |

## PARIMET THEMELORE TË ETIKËS DHE INTEGRITETIT

Etika dhe integriteti institucional/akademik mbështeten në këto parime

|                                            |                                                                                                                                                                                                  |
|--------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Ndershmëri akademike                       | Angazhimi etik për të vepruar me integritet, besueshmëri dhe përgjegjësi gjatë procesit të mësimit dhe kërkimit shkencor.                                                                        |
| Paanshmëri profesionale                    | detyrimi etik dhe ligjor i një individi për të kryer detyrat e tij pa u ndikuar nga paragjykimet, interesat personale apo presionet e jashtme                                                    |
| Përgjegjësi individuale dhe institucionale | Çdo anëtar i institucionit është përgjegjës për veprimet dhe vendimet e tij, si dhe për respektimin e standardeve etike dhe profesionale në kuadër të detyrave institucionale të cilat i ushtron |
| Respekt i dinjitetit njerëzor              | Të gjithë anëtarët e komunitetit akademik duhet të trajtojnë njëri-tjetrin me dinjitet, respekt dhe mirëkuptim, duke promovuar kulturë bashkëpunimi dhe komunikimi profesional.                  |
| Transparencë në veprim                     | Proceset akademike, administrative dhe kërkimore duhet të zhvillohen në mënyrë të hapur, të qartë dhe të dokumentuar, duke garantuar besueshmëri dhe llogaridhënie institucionale.               |
| Barazia dhe mos diskriminimi               | Institucioni garanton trajtim të barabartë për të gjithë, pa diskriminim mbi çfarëdo baze, në përputhje me legjislacionin dhe standardet e të drejtave të njeriut.                               |
| Llogaridhënie                              | Çdo person mban përgjegjësi për realizimin e detyrave dhe për pasojat e veprimeve të tij në kuadër të funksioneve akademike dhe institucionale.                                                  |

Çdo anëtar i institucionit është përgjegjës për respektimin e këtyre parimeve.

## I. HYRJE

Bazuar në Ligjin nr. 04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (tutje AKSP) është agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme e cila është përgjegjëse për ofrimin e trajnimeve dhe **arsimit të lartë**, zbatimin e politikave dhe strategjive të trajnimit, arsimimit të lartë si dhe zhvillimin e kapaciteteve në fushën e sigurisë publike për të gjitha Institucionet e Sigurisë Publike duke mos u kufizuar vetëm në: Policia e Kosovës, Shërbimi Korrektues i Kosovës, Shërbimi Sprovues i Kosovës, Dogana e Kosovës, Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave dhe Inspektorati Policor i Kosovës.

Në kuadër të Strukturës organizative të AKSP-së funksionon edhe Fakulteti i Sigurisë Publike i cili zhvillon aktivitetin akademik dhe kërkimor në përputhje me standardet institucionale dhe kërkesat ligjore në fuqi. Në këtë kontekst, integriteti akademik dhe etika e hulumtimit përbëjnë elemente thelbësore për garantimin e cilësisë, besueshmërisë dhe përgjegjësisë në proceset mësimore dhe kërkimore.

### Qëllimi i Manualit

Ky manual ka për qëllim të ofrojë një udhëzues praktik për zbatimin e parimeve të etikës dhe integritetit akademik në AKSP/FSP. Ai synon të orientojë stafin akademik, administrativ dhe studentët në respektimin e standardeve profesionale dhe akademike, në përputhje me rregulloret dhe politikat institucionale ekzistuese.

Manuali kontribuon në:

- parandalimin e plagjiaturës dhe formave të tjera të shkeljeve akademike
- promovimin e ndershmërisë në mësimdhënie dhe hulumtim
- garantimin e sjelljes etike në aktivitetet akademike
- sigurimin e transparencës dhe drejtësisë në trajtimin e rasteve



### Rëndësia e Integritetit Akademik

Integriteti akademik përfaqëson bazën e funksionimit të një institucioni të arsimit të lartë dhe garanton besueshmërinë e rezultateve akademike dhe kërkimore. Respektimi i tij

ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e mësimdhënies, vlefshmërinë e hulumtimeve dhe reputacionin institucional.

Në këtë kuadër, promovimi i integritetit akademik dhe etikës së hulumtimit kontribuon në ndërtimin e një kulture institucionale të bazuar në ndershmëri, përgjegjësi dhe profesionalizëm.

## **Fusha e Zbatimit**

Ky manual zbatohet për të gjithë anëtarët e komunitetit akademik të AKSP/FSP, përfshirë:

- stafin akademik
- personelin administrativ
- studentët

Ai aplikohet në të gjitha aktivitetet akademike dhe kërkimore, përfshirë procesin mësimor, vlerësimin e njohurive, hartimin e punimeve akademike dhe zhvillimin e hulumtimeve shkencore.

## II. KORNIZA INSTITUCIONALE

Zbatimi i parimeve të etikës dhe integritetit akademik në AKSP/FSP mbështetet në përgjegjësitë e qarta të aktorëve institucionalë, të cilët kontribuojnë në ndërtimin dhe ruajtjen e një mjedisi akademik të ndershëm dhe profesional.

### **Roli i institucionit**

AKSP/FSP siguron krijimin e një mjedisi institucional që mbështet dhe promovon integritetin akademik dhe etikën e hulumtimit, përmes hartimit dhe zbatimit të politikave, rregulloreve dhe mekanizmave të nevojshëm institucionalë.

### **Roli i Këshillit të Etikës**

Këshilli i Etikës është organi përgjegjës për promovimin, mbikëqyrjen dhe trajtimin e çështjeve që lidhen me etikën dhe integritetin akademik në AKSP/FSP.

Në kuadër të kompetencave të tij, Këshilli i Etikës:

- promovon standardet e etikës dhe integritetit akademik
- trajton rastet e shkeljeve të etikës në përputhje me aktet normative në fuqi
- kontribuon në ndërgjegjësimin dhe edukimin e stafit dhe studentëve
- jep rekomandime për përmirësimin e praktikave institucionale

### **Roli i stafit akademik**

Stafi akademik ka përgjegjësi kyçe në garantimin e integritetit në procesin mësimor dhe në aktivitetet kërkimore.

Në këtë kuadër, stafi akademik:

- zbaton standardet e integritetit akademik në mësimdhënie dhe vlerësim
- siguron që studentët të respektojnë rregullat e ndershmërisë akademike
- shmang dhe parandalon çdo formë të shkeljeve akademike
- vepron në përputhje me parimet e etikës së hulumtimit
- raporton rastet e dyshuara të shkeljeve sipas procedurave përkatëse

### **Roli i studentëve**

Studentët janë përgjegjës për respektimin e parimeve të integritetit akademik në të gjitha aktivitetet e tyre mësimore dhe kërkimore.

Në këtë kuadër, studentët:

- dorëzojnë punime origjinale dhe respektojnë rregullat e citimit ;
- shmangin çdo formë të mashtrimit akademik;
- respektojnë standardet etike në realizimin e detyrave dhe hulumtimeve;
- bashkëpunojnë në ruajtjen e një mjedisi akademik të ndershëm.

### III. INTEGRITETI AKADEMIK

Integriteti akademik përbën një nga shtyllat themelore të funksionimit të AKSP/FSP dhe garanton ndershmërinë, besueshmërinë dhe cilësinë në procesin mësimor dhe kërkimor.

#### Koncepti i integritetit akademik

Integriteti akademik nënkupton respektimin e parimeve të ndershmërisë, përgjegjësisë dhe korrektësisë në të gjitha aktivitetet akademike. Ai përfshin sjelljen etike në mësimdhënie, vlerësim dhe realizimin e punimeve akademike, duke siguruar që rezultatet e arritura të jenë produkt i punës individuale dhe i përputhshëm me standardet akademike.

Në AKSP/FSP, integriteti akademik rregullohet përmes akteve normative në fuqi që përcaktojnë standardet e sjelljes dhe përgjegjësitë e stafit dhe studentëve.

#### Shkeljet e integritetit akademik

Shkelje e integritetit akademik konsiderohet çdo veprim që cenon parimet e ndershmërisë dhe korrektësisë në aktivitetet akademike.

Në përputhje me rregulloret dhe politikat institucionale në fuqi, shkeljet përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- plagjiaturën (përdorimi i punës së tjetrit pa citim të duhur)
- kopjimin gjatë provimeve apo formave të tjera të vlerësimit
- paraqitjen e punës së huaj si punë personale
- falsifikimin ose manipulimin e të dhënave akademike
- përdorimin e mjeteve të paautorizuara gjatë vlerësimit
- bashkëpunimin e paautorizuar në detyra individuale

Shkeljet trajtohen në përputhje me aktet normative përkatëse që rregullojnë përgjegjësinë disiplinore për stafin akademik dhe studentët në AKSP/FSP. Procedurat për trajtimin e shkeljeve të integritetit akademik zhvillohen në përputhje me rregulloret përkatëse institucionale dhe paraqiten në kapitullin përkatës të këtij manuali.

## IV. ETIKA E HULUMTIMIT

Etika e hulumtimit përfaqëson tërësinë e parimeve dhe standardeve që udhëheqin zhvillimin e aktiviteteve kërkimore në AKSP/FSP, duke garantuar integritet, besueshmëri dhe përgjegjësi në çdo fazë të hulumtimit në përputhje me standardet profesionale dhe shkencore.

Parimet dhe standardet e etikës së hulumtimit në AKSP/FSP bazohen në aktet normative në fuqi, në veçanti në Rregulloren (AKSP) Nr. 03/2025 për etikë dhe integritet në hulumtimin shkencor.

### Parimet themelore të etikës në hulumtim

Çdo aktivitet hulumtues zhvillohet në përputhje me këto parime:

- ✓ **Ndershmëria** – sigurimi i transparencës dhe saktësisë në dizajnimin, realizimin dhe raportimin e hulumtimit
- ✓ **Besueshmëria** – përdorimi i metodave të sakta shkencore dhe sigurimi i cilësisë së të dhënave
- ✓ **Respekti** – trajtimi me dinjitet i pjesëmarrësve, kolegëve dhe mjedisit
- ✓ **Përgjegjësia** – llogaridhënie për të gjitha fazat e hulumtimit dhe ndikimin e tij në shoqëri

### Transparenca dhe integriteti i të dhënave

Hulumtimi duhet të jetë i dokumentuar dhe i verifikueshëm dhe në këtë kuadër:

- të dhënat duhet të mbliidhen, ruhen dhe menaxhohen në mënyrë të sigurt
- rezultatet duhet të raportohen në mënyrë të saktë dhe të plotë
- burimet duhet të citohen në mënyrë korrekte
- çdo manipulim i të dhënave është i ndaluar

### Liria dhe pavarësia akademike

Stafi akademik dhe studiuesit gëzojnë liri akademike në:

- përzgjedhjen e temave të hulumtimit
- përdorimin e metodave shkencore
- publikimin e rezultateve

Kjo liri ushtrohet në përputhje me standardet etike dhe pa ndikime të papërshtatshme nga interesa të jashtme.

## **Trajtimi etik i pjesëmarrësve në hulumtim**

Në rastet kur hulumtimi përfshin njerëz ose grupe të tjera:

- duhet të respektohen dinjteti, privatësia dhe të drejtat e tyre;
- kërkohet pëlqimi i informuar i pjesëmarrësve;
- duhet të shmangët çdo dëm i mundshëm fizik, psikologjik apo social;

Në rastet kur hulumtimi përfshin mjedisin ose elemente të tjera, duhet të respektohen standardet përkatëse etike dhe ligjore.

## **Autorësia dhe publikimet shkencore**

Autorësia në publikimet shkencore bazohet në kontribut real në hulumtim.

Parimet kryesore përfshijnë:

- njohjen e drejtë të kontributit të çdo autori;
- ndalimin e autorësisë fiktive ose të pamërituar;
- transparencën në renditjen e autorëve

Publikimet duhet:

- të paraqesin rezultate të sakta dhe të paanshme;
- të shmangin publikimin e dyfishtë dhe vetë-plagjiaturën;
- të respektojnë standardet e citimit dhe referimit.

## **Konflikti i interesit**

Konflikti i interesit paraqet një situatë në të cilën interesat personale, financiare, profesionale apo institucionale të një studiuesi mund të ndikojnë ose të perceptohen se ndikojnë në objektivitetin, pavarësinë dhe integritetin e hulumtimit.

Konflikti i interesit nuk përbën në vetvete shkelje, por kërkon menaxhim të duhur për të garantuar besueshmërinë e rezultateve shkencore.

## **Sjelljet e papranueshme në hulumtim**

Sjelljet e papranueshme përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- plagjiaturën
- fabrikimin e të dhënave;
- falsifikimin e rezultateve;

- publikimin e dyfishtë dhe vetë-plagjiaturën;
- mos deklarimin e konfliktit të interesit;
- keqinterpretimin ose paraqitjen e shtrembëruar të rezultateve;
- mosrespektimin e standardeve etike dhe ligjore në trajtimin e pjesëmarrësve dhe të dhënave

Këto veprime përbëjnë shkelje serioze të etikës dhe integritetit në hulumtim dhe trajtohen sipas procedurave institucionale në fuqi.

## V. EDUKIMI DHE PROMOVIMI I INTEGRITETIT AKADEMIK

Edukimi dhe promovimi i integritetit akademik dhe etikës së hulumtimit përbëjnë një element të rëndësishëm për ndërtimin e një kulture institucionale të bazuar në ndershmëri, transparencë dhe përgjegjësi.

AKSP/FSP, përmes mekanizmave institucionale dhe në veçanti përmes Këshillit të Etikës, angazhohet në ndërgjegjësimin dhe edukimin e stafit dhe studentëve për respektimin e standardeve etike dhe akademike.

### Trajnimet dhe zhvillimi profesional

Në kuadër të promovimit të integritetit akademik, AKSP siguron trajnime periodike dhe mbështetje institucionale për zbatimin e standardeve të etikës dhe integritetit në përputhje me aktet normative në fuqi. Organizohen aktivitete trajnuese dhe informuese për stafin akademik dhe studentët.

Këto përfshijnë:

- trajnime për integritetin akademik dhe etikën e hulumtimit
- prezantime dhe ligjërata tematike
- aktivitete të zhvillimit profesional për stafin akademik

Qëllimi i këtyre aktiviteteve është rritja e njohurive dhe kapaciteteve për zbatimin e standardeve etike në mësimdhënie dhe hulumtim.

### Informimi dhe ndërgjegjësimi

AKSP/FSP siguron informimin e vazhdueshëm të komunitetit akademik për rëndësinë e integritetit akademik.

Në këtë kuadër:

- studentët informohen për rregullat e integritetit akademik në fillim të studimeve
- stafi akademik njoftohet për standardet dhe detyrimet etike në kuadër të angazhimit të tyre
- materialet udhëzuese dhe dokumentet përkatëse bëhen të qasshme për të gjithë

## **Roli i Këshillit të Etikës në promovim**

Këshilli i Etikës luan rol aktiv në promovimin e integritetit akademik përmes:

- organizimit të aktiviteteve ndërgjegjëse
- dhënies së rekomandimeve për përmirësimin e praktikave institucionale
- mbështetjes së iniciativave për edukimin etik

## **VI. PROCEDURAT INSTITUCIONALE**

Trajtimi i shkeljeve të etikës dhe integritetit akademik në AKSP/FSP zhvillohet në përputhje me aktet normative në fuqi, në veçanti me rregulloret që rregullojnë procedurat disiplinore për stafin akademik dhe studentët.

Ky kapitull paraqet në mënyrë përmbledhëse hapat kryesorë të procesit për qëllime orientuese, sepse procedurat e detajuara zhvillohen në përputhje me Rregulloren për procedurat dhe masat etike për personelin akademik dhe aktet tjera relevante në fuqi në AKSP.

### **Raportimi i shkeljeve**

Shkeljet e dyshuara të etikës dhe integritetit akademik raportohen me shkrim nga personeli i AKSP-së, studentët apo palët e tjera të interesuara.

Raportimi bëhet tek:

- Dekani dhe/ose Drejtori i Përgjithshëm
- si dhe, sipas rastit, tek Këshilli i Etikës

Raportimet mund të parashtrihen edhe nga palë jashtë institucionit (qytetarë, institucionet apo zyrtarë jashtë AKSP-ës). Njoftimet e pranuar procedohen pa vonesë tek organet kompetente për trajtim të mëtejshëm.

## **Fillimi i procedurës**

Procedura disiplinore fillon mbi bazën e një dyshimi të bazuar për shkelje të detyrave dhe përgjegjësi të personelit akademik.

Në varësi të natyrës së shkeljes:

- për shkeljet e lehta procedura iniciohet nga Dekani dhe/ose Drejtori i Përgjithshëm
- për shkeljet e rënda procedura zhvillohet nga Këshilli i Etikës

Procedura fillon brenda afateve të përcaktuara me aktet normative në fuqi.

## **Shqyrtimi dhe zhvillimi i procedurës**

Pas fillimit të procedurës, organet kompetente ndërmarrin veprimet e nevojshme për shqyrtimin e rastit, duke përfshirë:

- analizimin e fakteve dhe provave
- shqyrtimin e dokumentacionit përkatës
- marrjen e deklaratave nga palët dhe dëshmitarët
- ndërmarrjen e veprimeve të tjera të nevojshme për sqarimin e çështjes

Procedura zhvillohet në mënyrë të paanshme dhe në përputhje me legjislacionin përkatës për procedurën administrative.

## **Të drejtat e palëve në procedurë**

Gjatë zhvillimit të procedurës disiplinore garantohen të drejtat e palëve, përfshirë:

- të drejtën për t'u njoftuar për fillimin e procedurës
- të drejtën për t'u dëgjuar
- të drejtën për të paraqitur prova
- të drejtën për qasje në dokumentet relevante
- të drejtën për mbrojtje dhe asistim
- të drejtën për të ushtruar mjete juridike ndaj vendimit përfundimtar

## **Vendimmarrja**

Pas shqyrtimit të plotë të rastit, organet kompetente marrin vendim në përputhje me aktet normative në fuqi.

Vendimi bazohet në:

- faktet e konstatuara
- provat e administruara
- dispozitat përkatëse ligjore dhe rregullative

## **Njoftimi dhe dokumentimi**

Palët e përfshira njoftohen për vendimin në përputhje me procedurat institucionale. Vendimet dhe dokumentacioni përkatës administrohen dhe ruhen në mënyrë të rregullt, duke respektuar parimet e konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave.

## **VII. MONITORIMI DHE PËRDITËSIMI**

Zbatimi i këtij manuali monitorohet në mënyrë të vazhdueshme nga mekanizmat institucionalë të AKSP/FSP, me qëllim sigurimin e respektimit të parimeve të etikës dhe integritetit akademik, po ashtu parashihet të përgatiten raporte periodike mbi gjendjen e etikës dhe integritetit akademik, të cilat shqyrtohen nga organet përkatëse institucionale.

Këshilli i Etikës, në bashkëpunim me njësitë përkatëse institucionale, vlerëson nevojën për përditësimin e manualit në përputhje me:

- ndryshimet në legjislacionin dhe aktet normative në fuqi
- zhvillimet institucionale dhe akademike
- praktikat dhe sfidat e hasura gjatë zbatimit

Përditësimi dhe rishikimi i këtij manuali realizohet në përputhje me nevojat institucionale, me qëllim që ai të mbetet një dokument funksional, aktual dhe në harmoni me kornizën ligjore dhe aktet normative në fuqi. Manuali i nënshtrohet rishikimit periodik së paku një herë në tri (3) vite, si dhe në rastet kur paraqiten ndryshime ligjore, zhvillime institucionale apo nevoja të tjera që kërkojnë përditësimin e tij.